

22 -03- 2021

Ref. 2103/364/BA/y.f



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Nr.11/2021

Bordi për Ankesa, i përbërë nga Ylber Fetahaj, kryetar dhe Avdyl Hyseni e Ilaz Rudaku anëtarë, lidhur me Ankesën me numër Ref:2103/286/BA/y.f të datës 08.03.2021 të parashtruesit “Grupi Koha” SH.P.K të përfaqësuar nga avokatët Arianit Koci dhe Granit Vokshi me adresë në rrugën Robert Dollli nr.34, Prishtinë, të paraqitur ndaj Vendimit Ref:2102/163/KPM/xhl, të datës 11.02.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur me datën 12.03.2021 mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar Ankesa Ref:2103/286/BA/y.f e datës 08.03.2021 e parashtruesit “Grupi Koha” SH.P.K dhe të përfaqësuar nga avokatët Arianit Koci dhe Granit Vokshi, me adresë në rrugën Robert Dollli, nr.34, Prishtinë, dhe mbetet në fuqi Vendimi Ref:2102/163/KPM/xhl, i datës 11.02.2021 i Komisionit të Pavarur të Mediave.

A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin Ref:2102/163/KPM/xhl, i datës 11.02.2021, Palën përgjegjës e ka sanksionuar me vërejtje në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, për shkeljen e nenit 14 paragrafi 5 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komercialë Audiovizuale

Kundër këtij Vendimi në afatin e paraparë ligjor “Grupi Koha” SH.P.K me datën 08.03.2021 ka parashtruar Ankesë pranë Bordit për Ankesa, për shkak të: zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, procedurave për vënien e sanksioneve dhe sanksionit të shqiptuar me propozim që Bordi për Ankesa të aprovojë Ankesën si të bazuar në tërësi dhe të anulojë Vendimin e kundërshtuar.

Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datën 12.03.2021 ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha pretendimet ankimore të Palës ankuese “Grupi Koha” SH.P.K, si dhe ka analizuar të gjitha provat tjera të cilat kanë rezultuar me marrjen e Vendimit Ref:2102/163/KPM/xhl, të datës 11.02.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Bordi për Ankesa konstaton se pretendimet e Palës ankuese lidhur me gjendjen faktike dhe shkeljen ligjore nga ana e Komisionit të Pavarur të Mediave, janë të pa bazuara, sepse Komisioni i Pavarur i Mediave, me rastin e marrjes së Vendimit të kundërshtuar e ka vlerësuar plotësisht gjendjen faktike, duke u bazuar në dispozitat materiale, përkatësisht në pajtim me nenin 14 paragrafi 5 të Rregullores KPM-2017/07, si dhe dispozitat procedurale që rregullojnë këtë fushë.

Andaj Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar në nenin 44 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenin 10 paragrafi 2 i Rregullores Nr. BA 2018/01 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi unanimisht si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi mund të inicohet konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Palëve dhe
- Arkivit të KPM-së.



Vjeter Fetahaj
Kryetar i Bordit për Ankesa